



## NEWSLETTER

Maj 2024

Nr.5

### Takimi bilateral i ASHMA-së dhe KPM në Prishtinë



Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe Komisioni i Pavarur për Media i Republikës së Kosovës (KPM) më 22 maj në Prishtinë, ranë dakord për thellimin e bashkëpunimit të ndërsjellë dhe rritjen e shkëmbimit të praktikave të mira në fushën e rregullativës mediatike. Përfaqësuesit e dy trupave rregullatore biseduan për disa çështje lidhur me harmonizimin e rregullativës vendase me atë evropiane dhe zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Direktiva e rishikuar për Shërbimet Mediatike Audiovizuele. Fokus (vëmendje) e veçantë iu kushtua mënyrës së realizimit të monitorimit të përmbajtjeve mediatike gjatë proceseve zgjedhore.

Gjatë takimit, rregullatori i Kosovës prezantoi sistemin për monitorimin e përmbajtjeve programore të transmetuara në radio dhe televizione, si dhe marrjen e sinjaleve të operatorëve që ritransmetojnë shërbime programore. Në fund të takimit u konstatua se marrëdhëniet bilaterale janë shumë të rëndësishme dhe se kjo praktikë do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

### Publikimi i raporteve për përfaqësimin mediatik zgjedhor në rrethin e dytë të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Presidenciale 2024 dhe Zgjedhjet Parlamentare 2024

Më 30 maj, ASHMA i publikoi raportet për prezantimin mediatik zgjedhor për Zgjedhjet Parlamentare 2024 nga data 18 deri më 22 prill dhe nga 25 prill deri më 6 maj dhe për rrethin e dytë të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Presidenciale 2024 nga data 25 prill deri më 6 maj. Monitorimi përfshinte 10 shërbime programore të televizioneve komerciale kombëtare: TV Alsat-M; TV Alfa; TV Kanal 5; TV Sitel; TV Telma; TV 21-M; TV Klan Maqedoni; Shenja TV; TV 24 Vesti dhe TV Sonce dhe programet e Shërbimit Publik – TVM 1, TVM 2 dhe kanali i Kuvendit. Shërbimet e tjera programore janë trajtuar në bazë të ankesave.

Lënda e mbikëqyrjes ishte programi i përgjithshëm gjatë ditë-natës, nga i cili u analizuan format e prezantimit mediatik zgjedhor. Nga TV ditarët/lajmet ku për analizë u veçua-edicioni qendror, dhe nga vëllimi i përgjithshëm i intervistave dhe debateve të transmetuara u përzgjedhën vetëm ato që përmbajtja kryesore e tyre ishin Zgjedhjet Presidenciale dhe/ose Zgjedhjet Parlamentare. Të gjitha televizionet nga kampioni i monitorimit të pasqyrimin mediatik të rrethit të dytë të Zgjedhjeve Presidenciale raportuan në mënyrë të drejtë, të balancuar dhe të paanshme, duke respektuar parimin e barazisë që është detyrim profesional i Kodit Zgjedhor. Raportimi i zgjedhjeve parlamentare nga shërbimet televizive u fokusua në informimin për aktivitetet e katër koalicioneve më të mëdha nga pushteti dhe nga opozita: Koalicioni për Ardhmërinë Evropiane, Koalicioni "Fronti Evropian", Koalicioni "Maqedonia Juaj" - VMRO DPMNE, dhe Koalicioni VLEN/VREDI. Vetëm TV Alsat – M arriti të sigurojë informacione për aktivitetet e të gjithë 17 pjesëmarrësve në fushatë.

Për shkak të mungesës së stafit primar gazetaresk dhe rritit korrespondent adekuat, asnjë nga redaksitë informative nuk arriti plotësisht të përmbushë detyrimin e mbulimit të balancuar të procesit zgjedhor bazuar në parimin e proporcionalitetit sipas numrit të listave të konfirmuara të kandidatëve për deputetë. Për këtë gjendje faktike, redaksi të caktuara e kanë informuar ASHMA-në edhe para fillimit të fushatës nga procesi i dyfishtë zgjedhor. Tek Shërbim Publik, edhe një herë u konfirmua se kufizimet në dispozitat e Kodit Zgjedhor për ndarjen e kohës në lajme, nuk japin një bilanc thelbësor në raportim. Detyrimin për aksesueshmërinë e përmbajtjeve për personat me aftësi të kufizuara, në përgjithësi e përmbushën të gjitha mediat e përfshira në analizën e monitorimit.

Raporti për prezantimin mediatik zgjedhor në rrethin e dytë të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Presidenciale 2024 është në dispozicion në [linkun](#).

Raporti për prezantimin mediatik zgjedhor për Zgjedhjet Parlamentare 2024 është në dispozicion në [linkun](#).



## NEWSLETTER

### Publikimi i raporteve për transmetimin e RPP për rrethin e dytë të Zgjedhjeve Presidenciale dhe për Zgjedhjet Parlamentare 2024

Agjencia më 23 maj, i publikoi raportet për reklamimin politik me pagesë (RPP) të transmetuara gjatë kohës së rrethit të dytë të Zgjedhjeve Presidenciale dhe Zgjedhjeve Parlamentare 2024. Në rrethin e dytë të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Presidenciale, gjithsej 57 transmetues (32 televizione dhe 25 radio) kanë lidhur kontrata me dy pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore. Nga 10 televizionet kombëtare, më shumë reklama transmetuan Kanal 5 (24 orë 1 minutë dhe 32 sekonda), Sitel (16 orë 25 minuta dhe 16 sekonda) dhe Alfa (14 orë 24 minuta dhe 43 sekonda), ndërsa nga 4 radiot kombëtare më shumë reklama kishin Antena 5 (8 orë 31 minuta dhe 40 sekonda) dhe Kanal 77 (4 orë 32 minuta dhe 7 sekonda). Për kandidatin për president (kryetar) Stevo Pendarovski janë transmetuar gjithsej 160 orë 58 minuta dhe 32 sekonda RPP (128 orë 48 minuta dhe 43 sekonda në TV dhe 32 orë 9 minuta dhe 49 sekonda në radio), ndërsa për kandidaten Gordana Siljanovska -Davkova gjithsej 122 orë dhe 22 sekonda RPP (75 orë 14 minuta dhe 5 sekonda në TV dhe 46 orë 46 minuta dhe 17 sekonda në radio). Sa i përket Zgjedhjeve Parlamentare, të 68 transmetuesve (39 televizione dhe 29 radio) që kanë lidhur kontrata me pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore gjithsej janë transmetuar 567 orë 43 minuta dhe 31 sekonda reklama politike me pagesë. Nga 11 televizionet kombëtare, volumin më të madhë të reklamave kishin Alsat-M (44 orë 12 minuta dhe 27 sekonda), Kanal 5 (35 orë 58 minuta dhe 4 sekonda) dhe TV Kompani 21-M (33 orë 5 minuta dhe 57 sekonda, nga 4 radio kombëtare më shumë reklama transmetuan Antena 5 (15 orë 22 minuta dhe 35 sekonda) dhe Kanal 77 (10 orë 6 minuta dhe 46 sekonda).

Raporti për RPP të transmetuesve për rrethin e dytë të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Presidenciale në periudhën nga 25 prilli deri më 6 maj 2024 është në dispozicion në [linkun](#).

Raporti për RPP të transmetuesve nga fushata zgjedhore për Zgjedhjet Parlamentare në periudhën nga 18 prilli deri më 6 maj 2024 është në dispozicion në [linkun](#).

### Raporti për RPP të transmetuesve për rrethin e parë të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Presidenciale 2024

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në pajtim me detyrimin nga neni 76-d paragrafi 8 të Kodit Zgjedhor, më 10 maj i ka dorëzuar Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve Raportin për reklamimin e paguar politik (RPP) të transmetuesve gjatë rrethit të parë të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Presidenciale, në periudhën nga 4 deri më 22 prill 2024. Nga 77 transmetues (39 TV dhe 38 RA) të regjistruar në Regjistrin e KSHZ-së, gjithsej 64 transmetues (37 TV dhe 27 RA) kanë lidhur kontrata me pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore.

Totali i reklamave politike të paguara nga transmetuesit ishte 567 orë 21 minuta dhe 39 sekonda. Prej tij, për Stevo Pendarovskin – 165 orë 2 minuta dhe 36 sekonda; Gordana Siljanovska Davkova – 154 orë 45 minuta dhe 37 sekonda; Bujar Osmani – 106 orë 57 minuta dhe 28 sekonda; Arben Taravari – 92 orë 55 minuta dhe 31 sekonda; Maksim Dimitrievski – 20 orë 6 minuta dhe 6 sekonda; Biljana Vankovska Cvetkovska – 17 orë 44 minuta dhe 15 sekonda; dhe për Stevço Jakimovski – 9 orë 50 minuta dhe 6 sekonda. Nga 9 televizionet kombëtare që lidhën kontrata për transmetimin e RPP, kohë më të madhe reklamimi kishin Alsat-M (38 orë, 43 minuta dhe 21 sekonda), Kanal 5 (30 orë 48 minuta dhe 8 sekonda) dhe Kompania 21- M (28 orë 2 minuta dhe 24 sekonda), ndërsa nga 4 radiot kombëtare që lidhën kontrata për transmetimin e RPP, kohë më të madhe reklamimi realizuan Antena 5 (16 orë 2 minuta dhe 32 sekonda) dhe Jon Radio (12 orë, 49 minuta dhe 18 sekonda).

Raporti mbi reklamën politike me pagesë të transmetuesve për rrethin e parë të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Presidenciale 2024 është në dispozicion në [linkun](#).

### Raport për prezantimin mediatik në rrethin e parë të fushatës për Zgjedhjet Presidenciale 2024

Agjencia më 2 maj, publikoi raportin për mënyrën e raportimit të transmetuesve në rrethin e parë të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Presidenciale, në periudhën nga 4 deri më 22 prill 2024. Në monitorim janë përfshirë 13 shërbime programore - televizionet komerciale kombëtare Alsat-M, Alfa, Kanal 5, Sitel, Telma, 24 Vesti, 21-M, Shenja, Klan Makedoni dhe Sonce dhe kanalet programore të Shërbimit Publik - TVMT 1, TVMT 2 dhe kanali parlamentar. Gjetjet e monitorimit rezultuan se pothuajse të gjitha televizionet në lajme respektuan parimin e trajtimit të barabartë gjatë prezantimit mediatik zgjedhor të kandidatëve për president (kryetar) të shtetit. Aktivitetet për fushatën presidenciale në të gjitha televizionet u ndanë në një rubrikë të veçantë informuese ku u shfaqën pjesë (pikë) të nxjerra nga fjalimet e kandidatëve para votuesve. Vetëm Shërbimi i Parë Programor i Radio Televizionit të Maqedonisë dhe TV 24 Vesti, realizuan intervista me të shtatë kandidatët për president të shtetit. Sa i përket debateve, vetëm TVM 1 ka arritur të organizojë një ballafaqim debatues ku kanë marrë pjesë të shtatë kandidatët për president të shtetit.

Nga aspekti i cilësisë audiovizuale të raportimit për fushatën presidenciale, për shkak të mungesës së rrjetit të përditësuar korrespondentësh, të pajisur me standarde prodhuese të njëjta, redaksitë ishin të detyruara të përshtatin material zgjedhor audiovizual nga grupet e shpërndara të komunikimit / marketingut të kandidatëve për president të shtetit ose nga profilet e tyre zyrtare në rrjetet sociale, gjë që u evidentua nga metoda e aplikuar e inçizimit/kuadrit (sfondit), nga mjedisi i prezantuar skenografik/ambienti për prezantimin zgjedhor dhe nga përpunimi grafik shtesë i materialit audiovizual të paraqitura nga media.



## NEWSLETTER

Me përjashtim të TV Klan Maqedoni, i cili në kundërshtim me Kodin Zgjedhor, nuk siguroi informacion për procesin zgjedhor në format të aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuara, të gjitha shërbimet programore të përfshira në monitorim ofronin çdo ditë një edicion të lajmeve qendrore TV dhe gjatë javës një edicion të emisioneve aktual-informativë me titra ose me përkthim në gjuhën e shenjave për personat me aftësi të kufizuara shqisore.

Raporti për mënyrën e raportimit të transmetuesve në rrethin e parë të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Presidenciale 2024 është në dispozicion në [linkun](#).

### Përkujtimi i transmetuesve për rregullat në periudhën e heshtjes zgjedhore

Në muajin maj, Agjencia dy herë i përkujtoi transmetuesit për rregullat që zbatohen gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore. Në rastin e parë, për shkak të përsëritjes së votimit për Zgjedhjet Parlamentare 2024 në shtatë vendvotime në Njësitë Zgjedhore 5 dhe 6, Agjencia ka njoftuar transmetuesit kombëtarë dhe transmetuesit që transmetojnë program në zonën e Ohrit, Krushevës, Strugës, Dollnenit dhe Zhelinës se për ta vlejnë detyrimet për heshtjen zgjedhore, nga mesnata e datës 20 maj deri në orën 19:00 të datës 22 maj 2024. Në rastin e dytë, janë njoftuar të gjithë transmetuesit se nga mbrëmja e mesnatës e 6 majit deri në orën 19:00 të datës 8 maj, zgjat heshtja zgjedhore për Zgjedhjet Presidenciale dhe Parlamentare 2024.

Në njoftime, thuhet se gjatë kohës së heshtjes, mediat vazhdojnë të raportojnë për procesin zgjedhor, por ndërpriten të gjitha format e prezantimit mediatic zgjedhor të pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore. Sipas Kodit Zgjedhor, për shkelje të heshtjes zgjedhore llogaritet transmetimi i çdo informacioni, fotografie, materiali audio dhe audiovizual që lidhet ose në të cilin marrin pjesë pjesëmarrësit në zgjedhje, çdo formë e raportimit mediatic që është i hapur ose i fshehtë në funksion të fushatës së dikujt dhe që mund të ndikojë në vendimin e votuesit, të dhënat që zbulojnë identitetin e subjekteve politike dhe/ose individëve të përfshirë në incidente apo parregullsi në ditën e votimit; si dhe deklarata nga kandidatët në procesin zgjedhor, nga përfaqësues të partive politike dhe nga bartës të funksioneve në organet qeveritare.

### Mbikëqyrje mbi prezantimin mediatic zgjedhor të TV Alfa

Gjatë monitorimit të prezantimit mediatic zgjedhor të programit TV Alfa, të transmetuar më 25 prill 2024, Agjencia konstatoi shkelje të nenit 75-f, paragrafi 1 të Kodit Zgjedhor.

Gjatë rrethit të dytë të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Presidenciale 2024, TV Alfa në orët reale të programit të transmetuar nga ora 08:00 deri në orën 9:00, nga ora 9:00 deri në orën 10:00, nga ora 10:00 deri në orën 11:00, nga ora 11:00 deri në orën 12:00 dhe nga ora 12:00 deri në orën 13:00, ka transmetuar më shumë se 4 minuta reklamim të paqar politik për kandidatin për president. të mbështetur nga partia politike VMRO-DPMNE.

### Mbikëqyrja e transmetuesve

Mbikëqyrja e jashtëzakonshme administrative për përmbyshjen e detyrimeve nga neni 62 paragrafi 6 të LSHMAAV dhe neni 21 paragrafët 3 dhe 4 të Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për dhënien e lejes për transmetim televiziv dhe radio është kryer mbi Televizionin News nga Kumanova. Nga mbikëqyrja u konstatua se redaktori përgjegjës i SHTR TV News SHPKNJP Kumanovë është i punësuar tek transmetuesi në marëdhënie të rregullt pune dhe me orar të plotë pune, i cili i përmbysh obligimet ligjore.

### Masat e shqiptuara paralajmërim publik

Në bazë të konstatimeve nga mbikëqyrja, Këshilli i Agjencisë në seancën e 21-të mbajtur më 10 maj, ka miratuar Aktvendim për shqiptimin e masës paralajmërim publik për operatorin Total TV nga Shkupi, për shkak se në pakon e saj programore nuk ka siguruar shërbimet programore të shërbimit publik radiodifuziv "TVM2", "TVM4" dhe "TVM5" që është në kundërshtim me nenin 143 paragrafi 3 të LSHMAAV.

